

**UDHËZIM**  
**Nr. 5, datë 23.2.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR NOTERË QË DO TË PRANOHEN NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 6 dhe të pikës 3, të nenit 142, të ligjit nr. 110/2018, “Për Noterinë”,

**UDHËZOJ:**

1. Numri i kandidatëve për noterë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, është 10 (dhjetë).

2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**